

ÉVALUATION DIAGNOSTIQUE
DES ÉLÈVES ALLOPHONES

Compréhension de l'écrit

CYCLE 4 - FIN DE 4E

Langue d'origine : albanais

MBIEMRI:

EMRI:

NIVEAU : FIN DE 4^e**DOKUMENTI 1****Raport UNICEF 2015 (Fragment):**

Njëzetepesë vite më parë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Që atëherë, miliona fëmijë kanë përfituar nga progresi. Kur shtetet, partnerët e tyre ndërkombëtarë, ndërmarrjet dhe komunitetet investuan fondet dhe energjitë e nevojshme, ashtu sikurse kishin marrë përsipër, ata bënë të mundur shpëtimin apo përmirësimin e jetës së qindra miliona fëmijëve. Edhe pse ka pasur ecuri të konsiderueshme në fusha themelore (mbijetesa e fëmijëve, shkollimi, furnizimi me ujë të pastër) një numër shumë i madh fëmijësh ende përballet me nevoja të paplotësuara, mosrespektim të të drejtave dhe kufizim të perspektivave për të ardhmen.

DOKUMENTI 2**Statistikat sipas Raport UNICEF 2015 (Fragment):**

ZONA GJEOGRAFIKE	PËRQINDJA NETO E ARSIMIMIT NË SHKOLLË FILLORE (6 -11 VJEÇ) (%)		PËRQINDJA NETO E ARSIMIMIT NË SHKOLLË TË MESME (12-16 VJEÇ) (%)	
	DJEM	VAJZA	DJEM	VAJZA
AFRIKA NËNSAHARIANE	81	75	35	30
LINDJA E MESME DHE AFRIKA E VERIUT	92	89	72	67
AZIA E JUGUT	94	94	55	48
AZIA LINDORE DHE PAQËSORI	95	95	75	76
AMERIKA LATINE DHE KARAIBET	93	94	71	75
EVROPA	95	95	-	-
BOTA	92	90	66	63

DOKUMENTI 3

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës [Fragmente]

Neni 24

1. Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar shëndetin më të mirë të mundshëm dhe për të përfituar shërbime mjekësore dhe riaftësimi. Ato bëjnë përpjekje për të garantuar që asnjë fëmijë të mos privohet nga e drejta për të akses në këto shërbime.

Neni 28

1. Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të garantojnë ushtrimin e kësaj të drejte në mënyrë progresive dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ato:

- a) E bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- b) Përkrahin zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm, si të përgjithshëm ashtu dhe profesional, duke i bërë ato të hapura dhe të aksesueshme për çdo fëmijë.

Neni 32

1. Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe për të mos qenë i detyruar të kryejë punë që përbëjnë rrezik apo që cenojnë shkollimin e tij ose dëmtojnë shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral apo shoqëror.

1

Cila është tema e përbashkët e tre dokumenteve ? (Rrethoni përgjigjen e saktë)

- Gjendja e fëmijëve në botë.
- Puna e fëmijëve në vendet në zhvillim.
- Shkollimi i fëmijëve në Evropë.

MI

MF

MS

TBM

2

Në cilin vit daton Konventa e të Drejtave të Fëmijës e përmendur në dokumentin 1? (Rrethoni përgjigjen e saktë)

- 1985
- 2015
- 1990

MI

MF

MS

TBM

3

Cilit neni të konventës (dokumenti 3) i referohet dokumenti 2? (Rrethoni përgjigjen e saktë)

- Neni 24
- Neni 28
- Neni 32

MI

MF

MS

TBM

4

Shënoni me x kutitë e tabelës më poshtë për t’iu përgjigjur pyetjeve, duke u bazuar te dokumenti 2:

ZONA GJEOGRAFIKE	NË CILËN ZONË GJEOGRAFIKE KA PO AQ DJEM SA EDHE VAJZA NË SHKOLLËN FILLORE?	NË CILËN ZONË GJEOGRAFIKE KA MË TEPËR VAJZA SE DJEM TË REGJISTRUAR NË SHKOLLË TË MESME?
AFRIKA NËNSAHARIANE		
LINDJA E MESME DHE AFRIKA E VERIUT		
AZIA E JUGUT		
AZIA LINDORE DHE PAQËSORI		
AMERIKA LATINE DHE KARAIBET		
EVROPA		

MI MF MS TBM

5

Që prej hartimit të Konventës: (Rrethoni përgjigjen e saktë)

- Situata e fëmijëve është përmirësuar.
- Të gjitha problemet e fëmijëve janë zgjidhur .
- Situata e fëmijëve nuk ka ndryshuar.

MI MF MS TBM

6

Për çfarë shërbejnë dokumentet e propozuara? (Bashkoni alternativat)

- | | |
|---------------|----------------------------------|
| Dokumenti 1 • | • Për informim |
| Dokumenti 2 • | • Për argëtim |
| Dokumenti 3 • | • Për të cituar zyrtarisht ligje |

MI

MF

MS

TBM

Rappel des codes de correction :

MI = maîtrise insuffisante MF = maîtrise fragile MS = maîtrise satisfaisante TBM = très bonne maîtrise

MI et MF : non acquis MS et TBM : on considère que c'est acquis